

VENDIM
Nr.383, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 15 për qind.

3. Rritje pensioni përfitojnë:

a) në masën 8 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë;

b) në masën 15 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 7 850 (shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj dhe jo më shumë se 15 700 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 3430 (tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë në muaj.

6. Rritja e pensioneve, e parashikuar nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

7. Shtesa mujore, e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet në masën 8 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin e Presidentit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994 të rriten në masën 8 për qind.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, në shumën 1 968.2 milionë lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano